



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE - MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE - MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS - PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA - TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

TVSH – NDRYSHIMI I NORMËS PREJ 15% NË 16%
UDHËZUES PËR BIZNESET E REGJISTRUARA PËR TVSH

Dhjetor, 2008

HYRJE

NGRITJA E NORMËS PREJ 15% NË 16%

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Me këtë Ligj është ngritur norma e TVSH-së nga 15% në 16%. Norma e re hyn në fuqi prej 1, Janarit 2009 dhe ky ndryshim prek çdo biznes të regjistruar për TVSH që krye shitje dhe blerje të mallra dhe shërbime ose importon mallra tjera nga ato që janë të liruara. TVSH-ja në importimin e mallrave dhe TVSH-ja në blerjet e mallrave dhe shërbimeve do të jetë më e lartë dhe si rezultat i kësaj TVSH e zbritshme do të jetë më e lartë.

Do të krijohet forma e re e TVSH-së që mundëson raportim të saktë të TVSH-së për periudhën e parë që ndikohet nga norma e re. (deklarata e TVSH-së do të dorëzohet deri më 28, shkurt 2009 për periudhën tatimore Janar 2009).

QËLLIMET E KËTIJ UDHËZUESI

Ky udhëzues do ti ndihmojë tatimpaguesit e TVSH-së që të kalojnë në normën e re prej 16%. Kërkohe shumë më tepër se sa vetëm thjeshtë zëvendësimi i normës së vjetër prej 15% me normën e re prej 16%. Prandaj Administrata Tatimore e Republikës së Kosovës dëshiron të inkurajoj dhe asistoj bizneset në mënyrë që ato të bëjnë ndryshimet e nevojshme në lidhje me ndryshimin e normës.

ASISTENCA E MËTEJME

Nëse keni ndonjë pyetje në të cilën ju nuk keni qenë në gjendje të gjeni përgjigje brenda përmbajtjes së këtij udhëzimi, ju lutem kontaktoni Departamentin e Edukimit të Tatimpaguesve në Zyrën Qendrore të Administratës Tatimore të Kosovës.

Kontaktet:

Tel. 038 200 25 017

Email : info@atk-ks.org

Web : www.atk-ks.org

Ky shërbim është në dispozicion prej 8.30 deri në 15,30 prej të hënës deri në të premten.

1. SHITJET

1.1 Kur duhet të filloni që të ngarkoni normën prej 16%?

Ju duhet të ngarkoni normën prej 16% në furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të bëra me 1 janar ose pas kësaj date të vitit 2009. Nëse dëshironi të keni më shumë informata lidhur me atë se kur ndodh furnizimi për qëllime të TVSH-së (“momenti tatimor”) ju lutem shikoni aneksin 5 të këtij udhëzuesi.

1.2 Cilat nga shitjet do të përlogariten me normën e re ?

Duhet të bëhet dallimi si në vijim:

1.2.1 Nëse je biznes i regjistruar për TVSH (p.sh një shitore, restorant) dhe bëni furnizime për klientët jo biznesor për të cilët nuk duhet të lëshoni fatura tatimore:

Ju duhet të shfrytëzoni normën e re prej 16% për të gjitha kompensimet që ju i pranoi me 1 janar ose pas 1 janarit 2009.

1.2.2 Nëse jeni biznes i regjistruar për TVSH që bën furnizime për bizneset tjera të regjistruara dhe duhet të lëshoni fatura të TVSH-së:

Ju duhet të shfrytëzoni normën e re për të gjitha faturat e TVSH-së që ju i lëshoni me 1 janar apo pas 1 janarit 2009.

Ju duhet të lëshoni një faturë tatimore me ose para 15 janarit 2009 nëse keni furnizuar mallra dhe shërbime para 1 janarit, ose nëse keni pranuar pagesë për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve para 1 janarit 2009. Në këto rrethana shitja ndodh para 1 janarit 2009 dhe ju duhet të shfrytëzoni normën e vjetër prej 15%.

Faturat e tilla duhet ti deklaroni në deklaratën e TVSH-së për muajin dhjetor të vitit 2008.

Nëse ju keni pranuar një pagesë të pjesërishme para 1 janarit 2009 shfrytëzoni normën e vjetër për pagesën e pjesërishme.

Rregullat speciale:

- Për bizneset që bëjnë furnizime të vazhduara të mallrave dhe shërbimeve: shih 5.3.2 të Aneksit 5; dhe
- Furnizimet e vetme të mallrave dhe shërbimeve të bëra gjatë periudhës kohore shih 5.3.3 të Aneksit 5.

1.3 Çka është “momenti tatimor”?

Momenti Tatimorë për qëllime të TVSH-së është përcaktimi se kur ndodh shitja gjithashtu e njohur si “koha e furnizimit”. Këto rregulla janë përmbledhur në Aneksin 5 të këtij udhëzuesi.

1.4 Si të llogaritet TVSH-ja nëse çmimet përfshijnë TVSH-në:

Ju duhet të bëni zbrërthimin e TVSH-së për të përcaktuar shumën e TVSH-së. TVSH-ja zbrërthehet nëse:

Për shembull:

Aty ku shuma e TVSH-së nuk është listuar ndarazi në faturën tatimore, TVSH-ja për atë furnizim do të llogaritet duke pjesëtuar vlerën totale me 7.25. Ndryshimi në mes të çmimit përfshirës të tatimit të vlerës së shtuar dhe TVSH-së do të jetë vlera e tatueshme. Për shembull, nëse çmimi i mallit i vendosur në vitrinën e shitores është 116 euro përfshirë TVSH-në, mund të gjejmë shumën e TVSH-së për atë furnizim duke pjesëtuar 116 me 7.25 që na jep 16 euro . Vlera e tatueshme është 100 euro, kështu $116-16=100$.

1.5 Si të korrigjoj TVSH-n e ngarkuar me normë të gabuar (notë krediti):

Nëse ngarkoni normën e gabuar të TVSH-së në faturë, ju duhet ti jepni klientit të juaj një notë krediti ose notë debiti për të korrigjuar gabimin. Notë krediti/notë debiti duhet të përmbajë detalet si në vijim:

- Numrin identifikues dhe datën e lëshimit të notë kreditit/notë debitit;
- Emrin e juaj, adresën dhe numrin e regjistrimit të TVSH-së;
- Emrin dhe adresën e klientit të juaj;
- Numrin e identifikimit dhe datën e lëshimit të faturës së TVSH-së;
- Përshkrimin i cili identifikon mallrat ose shërbimet e furnizuara; dhe
- Shumën e TVSH-s që është korrigjuar.

Çdo notë krediti ose notë debiti e lëshuar në pajtueshmëri me rregullat për shitje që përfshijnë ndryshimin e normës duhet të lëshohet para ose me 30 janar 2009.

1.6 Çështjet praktike:

1.6.1 Bizneset e regjistruara për qëllime të TVSH-së që bëjnë shitje për klientët jo biznesor:

Shumica e bizneseve të tilla kanë sisteme të arkave fiskale të cilat llogarisin TVSH-në në pikën e shitjes. Nëse ju shfrytëzoni një sistem elektronik për të regjistruar shitjet ju duhet të siguroheni se është sistemi i juaj është rregulluar që të aplikojë normën e re me efekt prej 1 janarit 2009. Ndoshta ju do të keni nevojë që të kontaktoni prodhuesin apo furnizuesin e sistemit tuaj për të parë se si të bëni rregullimet e nevojshme.

1.6.2 Çka me faturat për personat që nuk janë regjistruar për qëllime të TVSH-së?

Nëse lëshoni një faturë me TVSH për personat që nuk janë të regjistruar për qëllime të TVSH-së me kërkesë të tij, ju duhet të siguroheni që ato të tregojnë saktë TVSH-në dhe normën e saj. Kjo në veçanti do të shmang pyetjet nga klientët e juaj.

1.6.3 Çka në lidhje me zbritjet për shitjet e bëra me ose pas 1 Janarit, 2009?

Nëse jepni zbritje me ose pas 1 janarit, 2009 për shitjet e bëra para 1 janarit 2009, ju duhet të rregulloni shitjet bruto ditore duke marrë parasysh TVSH-në e ngarkuar në fillim me 15%. Zbërthimi i TVSH-së që duhet të rimburohet është 15/115 e çmimit duke përfshirë TVSH-në.

1.6.4. Çka me makinat që veprojnë me monedha të metalta siç janë ato për shitje, argëtim dhe makinat për lojëra?

Ju nuk mundë të vononi përlllogaritjen e normës së re të TVSH-së derisa të largohen monedhat e metalta apo zhitonat nga makina.

Mirëpo sido që të jetë në kohën e ndryshimit me 1 janar 2009 nga ju kërkohet që të llogaritni TVSH duke u bazuar në atë datë për periudhën e shfrytëzimit para 1 janarit. Nëse makina nuk i regjistron këto informata dhe ju keni larguar monedhat ose zhitonat pas 31 dhjetorit 2008, ju duhet të shpërndani marrjet dhe ju mundë të aplikoni normën e TVSH-s prej 15% për shitjet para 1 janarit 2009 – përndryshe ju duhet të ngarkoni fitimin me 16%.

2. BLERJET DHE E DREJAT PËR ZBRITJE TË TVSH-S SË ZBRITËSHME E AUSHTUQUAJTUR SI KREDITIMI I TVSH-S SË ZBRITËSHME:

2.1 Kur duhet të filloj njohjen e TVSH-s së zbritshme e cila është ngarkuar me 16%?

Tatimpaguesi i regjistruar për TVSH e bën njohjen e tij të parë të TVSH-së së zbritshme me normën prej 16% si kredit kundrejt TVSH-së së llogaritur me normën prej 16% për periudhën tatimore të janarit 2009 pra në deklaratën tatimore që do të dorëzohet deri me 28 shkurt 2009.

2.2 Grupi i dyfishtë i rregullave që mundësojnë të drejtën e zbritjes së TVSH-së:

2.2.1 Grupi i parë i rregullave nëse e drejta për zbritje të TVSH-së është e lejueshme:

Thyerja ndodh sipas rregullave normale për zbritjen e TVSH-së sikur që është shpjeguar në Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2004, të datës 1 shtator të vitit 2004 mbi implementimin e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.

2.2.1.1 Kjo përfshinë se krediti i tatimit të zbritshëm nuk duhet të lejohet për TVSH-në e paguar ose që do të paguhet lidhur me furnizimet që nuk janë shfrytëzuar ose nuk do të shfrytëzohen për furnizime të tatueshme të bëra nga tatimpaguesit e TVSH-së. Pra ju nuk mundë të merrni kreditin e juaj për TVSH-n e juaj të zbritshme për furnizimet e përjashtuara që i bëni.

2.2.1.2 Këto rregulla përfshijnë gjithashtu se krediti i tatimit të zbritshëm gjithashtu nuk lejohet për TVSH në rastet si në vijim:

a) Për blerjet e karburanteve, me përjashtim kur:

- Sfera e aktivitetit është tregtia me karburante;
- Karburantet janë të domosdoshme për nevoja teknologjike të aktivitetit sikurse në rastin e karburanteve të kompanisë transportuese, karburanteve për ngrohje qendrore, karburante për kamionët për shpërndarje.

b) Për shpenzimet e udhëtimit, përfaqësimit, akomodimit, ushqimit dhe argëtimit;

c) Për shpenzimet e lidhura me veturat, me përjashtim kur:

- Fusha e aktivitetit është tregtia me vetura;

- Shfrytëzimi i veturave është aktivitet i vetëm i tatimpaguesit të TVSH-së sikurse në shërbimet e dhënies me qira, shërbimeve të taxit, shërbimeve të ambulancës dhe shërbimeve të funeralit

d) Për shërbimet që kanë të bëjnë me pikat e listuara nga a) deri në c).

2.2.2 Grupi i dytë i rregullave nëse e drejta për zbritje është e lejueshme (e quajtur si momenti i zbritjes së TVSH-së së zbritshme):

Në fakt, rregullat e shpjeguara për “Shitjet” janë të njëjta edhe për “Blerjet”.

Kjo do të thotë se “momenti tatimor” për shitjet është “momenti i zbritjes së TVSH-së së zbritshme” për blerjet. Mirëpo zbritja e TVSH-së së zbritshme lejohet vetëm nëse blerësi, përveç asaj që është përshkruar në 2.3.1 më poshtë posedon evidencat si në vijim¹:

- a) Për importet dhe eksportet, deklaratën autentike të doganës (Dokumentin Unik Doganor në rast të importeve, Dokumentet Unike Doganore dhe kopjen e deklaratës së Doganës të vendit pranues. Këto dokumente duhet të kompletohen me faturat e lëshuara
- b) Për të gjitha transaksionet tjera, një faturë autentike e lëshuar nga furnizuesi i cili është deklarues i TVSH-së;
- c) Dëshmia se borxhi është borxh i keq sikur që është referuar në nenin 22 të Ligjit të TVSH-së.

2.3 Çështjet Praktike:

2.3.1 Faturat e pranuar me ose pas 1 janarit 2009 me normën e re prej 16%?

Ju mundë të ngarkoheni me normën e re prej 16% nëse “momenti tatimor” është 1 janari 2009 ose ndonjë datë e më vonshme.

Mirëpo supozo se momenti tatimor ka qenë para 1 janarit 2009 dhe furnizuesi faturon me normën e re prej 16% ndërsa është dashur të jetë 15%. Mbani në mend se tatimpaguesi i cili është deklarues i TVSH-së është i lejuar të ju faturoj deri me 15 janar 2009.

Në mënyrë që të ulim ngarkesën e blerësve-tatimpaguesve për TVSH të cilët pranojnë fatura të tilla ,ATK-ja do të ju pranoj ato fatura nëse ju keni të drejtën për tërë kreditin e TVSH-së së zbritshme. Nëse nuk e keni të drejtën për tërë kreditin e TVSH-së së zbritshme, ju duhet të kërkonti nga furnizuesi i juaj një notë krediti për TVSH-në e mbi ngarkuar e cila ju mundëson që të bëni rregullimet.

¹ Këto evidence duhet të kompletohen me evidenca të tjera siç janë faturat tatimore, kontratat, evidencat e pagesave bankare etj.

2.3.2 Faturat e pranuar me ose pas 1 janarit 2009 me normën e vjetër prej 15% ?

Ju mundë të ngarkoheni me normën e vjetër prej 15% nëse “momenti tatimor” ka qenë para 1 janarit 2009.

Mirëpo supozo se momenti tatimor ka qenë me 1 janar 2009 dhe furnizuesi ju ngarkon juve me normën e vjetër prej 15%. Ju asnjëherë nuk duhet të pranoni faturat e tilla. Në mënyrë që të merrni kreditin e juaj të TVSH-së së zbritshme, ju duhet të kërkonit nga furnizuesi i juaj një notë debiti për TVSH-në e nën ngarkuar e cila ju mundëson që të bëni rregullimet.

2.3.3 Faturat jo të sakta të TVSH-së dhe zbrërthimi i TVSH-së.

Blerësi-tatimpaguesi i regjistruar për TVSH i cili nuk ka pranuar faturat e sakta të TVSH-së lidhur me furnizimet që ndodhin para 1 janarit 2009 duhet të korrigjojë llogaritjet për qëllime të kreditit të TVSH-së së tyre të zbritshme dhe duhet të ja bashkangjesin llogaritjet faturës jo të saktë. Ai mandej kërkon notë krediti.

Për të llogaritur elementin e normës prej 16% të përfshirë në vlerën e shitjeve ju duhet të shfrytëzoni ndarjen e re të TVSH-së me koeficient 7.25 të çmimeve të shitjes duke përfshirë TVSH-në prej 16%.

Shembull:

Furnizuesi faturon 116,000 (100,000 + 16,000 TVSH) euro për furnizimin me momentin tatimor para 1 janarit 2009.

TVSH-ja që duhet të korrigjohet është $116,000 : 7.25 = 16,000$ e cila saktësisht është TVSH-ja prej 16,000 të cilën e ka ngarkuar furnizuesi. Notë krediti duhet të jetë $16,000$ TVSH - $(100,000 \times 15\% \text{ TVSH}) = 1,000$ TVSH

3 Importet, depot doganore dhe eksportet

3.1 A i prek importet e juaja ndryshimi prej 15% në 16%, ?

Për qëllime të TVSH-s në importe mallrat në përgjithësi trajtohen si të importuara kur ato arrijnë në Kosovë nga vendi jashtë Kosovës dhe hyjnë në qarkullim të lirë pas vërtetimit të Dokumentit Unik Doganor të Doganës.

Të gjitha mallrat e sjella në qarkullim të lirë me ose pas 1 janarit 2009 i nënshtrohen normës së TVSH-së prej 16%.

3.2 Mallrat në depot doganore:

TVSH-ja bëhet obligim kur mallrat largohen nga depoja doganore dhe vihen në qarkullim të lirë. Varësisht nga rrethanat TVSH-ja mundë të lindë nga një importim ose furnizim i mallrave në depo doganore.

Norma e TVSH-së së ngarkueshme është ajo në fuqi në kohën kur mallrat janë larguar nga depoja doganore.

3.3 A i prek eksportet e juaja ndryshimi prej 15% në 16%?

Shitjet e juaja janë me shkallën zero, nëse ju i përmbushni kushtet për eksport. Nëse ju dështoni të keni evidencë për eksport, ju duhet të llogaritni TVSH-në në shitjet e juaja dhe duhet ta bëni këtë me normën në fuqi kur ka ndodh eksporti.

Trajtimi i TVSH-së së zbritëshme të blerjeve të mallrave dhe shërbimeve dhe mallrave të lidhura me këto eksporte janë shpjeguar në pjesën 2 të këtij udhëzuesi.

4 Nevoja për të bërë ndryshimet e nevojshme në faturim, sistem të kontabilitetit dhe arka fiskale

4.1 Regjistrimet manuale

Bizneset të cilat mbajnë regjistrime manuale nevojitet të bëjnë ndryshime të vogla. Çështja e tyre kyçe është që të sigurohen se janë duke futur normën e saktë të TVSH-së në librat e tyre të shitjeve dhe blerjeve për të regjistruar TVSH-në me të dy normat me të vjetrën dhe me të renë së paku për deklaratën e parë pas ndryshimit.

Për bizneset që mbështeten në sisteme më komplekse elektronike të kontabilitetit (duke përfshirë ato të brendshme dhe të softverëve të blerë) është e mundur që të nevojiten më shumë ndryshime.

4.2 Sistemet kompjuterike

Ju duhet të kontrolloni se softueri i juaj i kontabilitetit mundë të procesoj faturat e TVSH-së nga 1 Janari 2009 kur ju mundë të pranoni dhe lëshoni fatura të TVSH-së të cilat tregojnë ose normën 15% ose 16 % . Mirëpo sido që të jetë ju duhet të siguroheni se për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të bëra ose të pranuar me ose pas 1 janarit 2009 norma e TVSH-së që shfrytëzohet dhe që tregohet në faturë të jetë 16 %.

4.3 Çka nëse ju nuk mundë të ndryshoni sistemet e juaja në kohë, për ndryshimin e normës me 1 janar 2009?

Nëse ju nuk mundë të bëni ndryshimet e nevojshme në kohë në sistemin e kontabilitetit dhe faturimit të juaj kjo nuk do të thotë se është një problem shumë i madh. Ju mundë të

jeni në gjendje të bëni disa aranzhime të përkohshme ose rregullime manuale ashtu që të korigjohen shumën e TVSH-së në deklaratën e parë të juaj pas ndryshimit. Ju do të jeni përgjegjës për tu siguruar që ju po ngarkoni ose paguani normën e saktë prej 16% pavarësisht se a janë ndryshuar sistemet e juaja apo jo.

Për arkat fiskale të cilat me 1 janar 2009 ende do të llogarisin normën 15% :

Për të hyrat që ju i pranoni nga 1 janari 2009 e më tutje do të jeni të obliguar të llogaritni TVSH-në me normën 16%. Nëse sistemet e juaja (përfshirë arkat fiskale) nuk janë ndryshuar për të llogaritur me 16% (ndryshe nga 15%) deri me 1 janar, ju do të duhet të llogaritni TVSh-në në mënyrë manuale për pazarin ditor duke shfrytëzuar ndarjen e TVSH-së me koeficientin 7.25 të çmimeve të shitjes (shih 1.4 më lartë).

Ajo llogaritje duhet të reflektohet në baza ditore në librat e juaj të shitjes.

Për bizneset që lëshojnë fatura të TVSH-s me 1 janar 2009:

Ju duhet të siguroheni se ju po ngarkoni TVSH me normën 16% në faturën që ju e krijoni për shitjet e bëra me ose pas 1 janarit 2009.

- Për bizneset që lëshojnë fatura me dorë kjo do të jetë e lehtë .
- Për juve që lëshoni fatura në mënyrë automatike nga një sistem i kontabilitetit ju duhet menjëherë të eksploroni se si të ndryshoni fushën e TVSH-s nga 15% në 16%. Ju mundë të jeni në gjendje që ta bëni vetë, ose ndodhë që ju duhet të kontaktoni siguruesin e softuerit tuaj për asistencë.

Shumica e pakove të softuerëve duhet të kenë mundësinë e ndërhyrjes brenda për të bërë ndryshimet në normë.

- Tolerancë e përkohshme mirëpo jo më vonë se 30 janari i vitit 2009 për ata që nuk kanë qenë në gjendje të ndryshojnë fushën e TVSH-së prej 15% në 16%.

Menjëherë lëshohet një notë debiti për faturat të cilat ende e shfrytëzojnë normën e vjetër prej 15%. Në këtë notë debiti shuma shtesë e TVSH-së që duhet të paguhet për furnizuesin llogaritet duke shumëzuar çmimin e faturës që e ka të llogaritur TVSH-në me 15%, me ndarjen e TVSH-së me 1/100. Fatura me TVSH-në e llogaritur me normën prej 15% dhe notë debiti me TVSH-në e llogaritur nëpërmes të shumëzimit të çmimit me 1/100, është obligim për blerësin dhe duhet të paguhet për furnizuesin së bashku me çmimin e ri të shitjes. Të dy dokumentet (fatura dhe notë debiti) i bashkëngjiten njëra tjetrës dhe ofrojnë evidencë për qëllime të TVSH-së.

Po japim një shpjegim të shkurtër.

Shembull:

shitjet prej 100,000 + 15,000 TVSH = 115,000 (gabimisht është shfrytëzuar norma e vjetër)

TVSH-ja është e barabartë me: 15,000 TVSH (fatura me normën e vjetër prej 15%) + $(1/100) \cdot 100,000$ VAT = 15,000 + 1,000 = 16,000 (shuma e saktë e TVSH-së)

Llogaritja e 1% është shumë e lehtë dhe gjithashtu mundëson një lëshim të lehtë manual të notë debitit.

5 ANEKSI: RREGULLAT PËR PËRCAKTIMIN E KOHËS SË FURNIZIMIT

5.1 Kur ndodh furnizimi?

Për tu zbuluar se kur ndodh një furnizim ju duhet të dini kohën e furnizimit i cili gjithashtu është i njohur si “momenti tatimor”. Rregullat e momentit tatimor janë ato që ju duhet të shfrytëzoni për të vendosur kur të llogaritni për furnizim në deklaratën e juaj të TVSH-së. Këto rregulla janë të rëndësishme kur të ndryshojë norma.

Përshkrimi si në vijim ofron rregullat se si të përcaktohet “momenti tatimor”.

5.2 Rregullat e përgjithshme për mallrat dhe shërbimet:

- 5.2.1 Nëse ju furnizoni mallra atëherë momenti tatimor zakonisht është data kur ju i dërgoni mallrat te klienti i juaj ose kur klienti i merr ato. Kjo përfshinë furnizimet nën qiradhënie-bletje, shitjet me kredit ose marrëveshjet e shitjeve me kushte.
- 5.2.2 Nëse ju furnizoni mallrat mirëpo ato nuk do të dërgohen apo nuk do të merren (për shembull për shkak se ju i fusni ato së bashku në lokalet e klientit) atëherë momenti tatimor është data kur ju i vëni ato në dispozicion për klientin e juaj për ti shfrytëzuar.
- 5.2.3 Nëse ju furnizoni shërbime atëherë momenti tatimor është data kur është bërë shërbimi normalisht kjo merret si datë kur janë kryer të gjitha punët me përjashtim të faturimit.

Mirëpo pavarësisht a furnizoni mallra apo shërbime, rregullat normale për mallra dhe shërbime shfuqizohen nëse aplikohen rregullat e veçanta sikurse është shpjeguar në 5.3 më tutje.

5.3 Rregullat e veçanta

- 5.3.1 Nëse ju lëshoni faturë tatimore ose pranoni një pagesë para momenti tatimor sikur që është definuar sipas rregullave themelore, atëherë momenti tatimor është data që ju e lëshoni faturën apo e pranoni pagesën, cilado që të ndodh e para.
- 5.3.2 Furnizimet që janë në progres me 1 janar, 2009: Furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të cilat shkaktojnë krijimin e pasqyrave të një pas njëshme konsiderohen se kanë ndodh në skadimin e periudhës të cilës ajo pasqyrë apo pagesë i takon dhe momenti tatimor krijohet në atë moment.

Shembuj:

Pasqyrat e llogarive lidhur me furnizimin e mallrave (ujit, ngrohjes dhe elektricitetit) duhet të konsiderohen si te kryera në fund të periudhës të cilës ajo pasqyrë i takon.

Shërbimet e vazhdueshme janë për shembull dhënia me qira e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, operimet e kompanive distribuese të radios dhe TV.

- 5.3.3 Furnizimet e vetme të zhvilluara gjatë periudhës kohore të cilat përfshijnë ndryshimin e normës (p.sh. shërbimi i ofruar nga avokati lidhur me një rast të gjyqit dhe shërbimet tjera intelektuale sikurse ato të kryera nga avokatët, kërkuesit e klientëve etj.): mundë të llogariten në vlerën e shërbimit të kryer para ndryshimit të normës prej 15%. Vlera e shërbimeve të bëra pas 1 janarit 2009 do të llogaritet me normën prej 16%. E njëjta vlen për furnizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes (p.sh fotokopjuesit) për intervenimet teknike të bëra para 1 janarit 2009.

Ky udhëzues si i tillë do të jetë i aplikueshëm vetëm nëse Ligji për TVSH i nxjerrur nga Parlamenti i Republikës së Kosovës do të nënshkruhen nga Kryetari i Republikës së Kosovës.

DJETOR 2008